



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 869/2 Prot.

Tiranë, më 27.09 2026

V E N D I M

Nr. 33 dt. 27.04 2026

PËR
DISA NDRYSHIME NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE E ANALITIKE TË
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", nenit 49, pika 1, gërma (ç), në Statutin e UST-së neni 43, gërma r), në VKM me nr. 243, datë 20.04.2023 "Për një ndryshim në VKM nr.748, datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të Arsimit të Lartë", të ndryshuar, në Udhëzimin e MASR nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL", në Vendimin nr. 50 dt. 31.10 2022 "Miratimin e nilelit të pagave sipas VKM në nivel maksimal të personelit akademik UST", në Vendimin e Senatit nr.13, datë 30.01.2026 "Për miratimin e strukturës organizative, analitike dhe klasifikimit të pagës për vitin 2026, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.11, datë 02.02.2026 "Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike, dhe klasifikimit të pagës për vitin 2026", në shkresën e Ministrisë së Arsimit me nr. 769/1 prot., datë 14.04.2026 "Njoftim për regjistrimin dhe numrin e regjistrimit për gradën shkencore "Doktor", në shkresën e Ministrisë së Arsimit me nr. 773/1 prot., datë 14.04.2026 "Njoftim për regjistrimin dhe numrin e regjistrimit për gradën shkencore "Doktor", në shkresën e Ministrisë së Arsimit me nr. 824/1 prot., datë 16.04.2026 "Njoftim për regjistrimin dhe numrin e regjistrimit për gradën shkencore "Doktor" si dhe në shkresën e Ministrisë së Arsimit me nr. 888/1 prot., datë 16.04.2026 "Njoftim për regjistrimin dhe numrin e regjistrimit për titullin akademik "Profesor", në Vendimin e Rektoratit datë 20.04.2026 "Për disa ndryshim në strukturën organizative e analitike të Universitetit të Sporteve të Tiranës" në Vendimin e Senatit Akademik nr. 63 datë 21.04.2026, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 27.04.2026,

V E N D O S I :

1. Miratimin e disa ndryshimeve në strukturën organizative dhe analitike të Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe përcaktimit të nivelit të pagës si më poshtë vijon:
 - **Z. Arben Simon Bici**, nga "Asistent Lektor" pranë Departamentit të Sporteve Kolektive, FSHL kalon në kategorinë "Doktor" (Lektor) nga data 10.03.2026 e në vazhdim.
 - **Z. Orges Adem Liçaj**, nga "Asistent Lektor" pranë Departamentit të Menaxhimit të Sportit dhe Turizmit, FVFR kalon në kategorinë "Doktor"(Lektor) nga data 09.03.2026 e në vazhdim.

- **Znj. Blerina Medat Mema**, Zv/Dekan në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, Deprtamenti i Edukimit dhe Shëndetit nga “Asistent Lektore” kalon në kategorinë “Doktor”(Lektor) nga data 26.03.2026 e në vazhdim.
 - **Z. Juel Ymer Jarani**, me titullin akademik “Profesor i Asociuar” pranë Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit, FSHL, kalon në kategorinë me titullin akademik “Profesor” nga data 31.03.2026 e në vazhdim.
2. Niveli i pagës do të jetë sipas Vendimit të Bordit të Administrimit me nr. 50, datë. 31.10 2022 "Miratimin e nivelit të pagave sipas VKM në nivel maksimal të personelit akademik të UST".
 3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Njësitë Kryesore, Administratori, Drejtorja e Burimeve Njerëzore Arkiv/Protokollit si dhe Drejtorja e Financës dhe Buxhetit në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur ÇOBANI

